



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

Drejtoria e Integritimit dhe Projekteve

**PROGRAMI I BURSAVE HUNGAREZE "AKADEMIA E DIPLOMACISË"
BUDAPEST 2015**

Në kuadër të bashkëpunimit dypalësh me Hungarinë, Universiteti Kombëtar i Shërbimit Publik në Budapest (Hungari) ka shpallur programin e bursave të plota dhe të pjesshme (Good Governance Scholarship 2015) për studentë/punonjës të shkëlqyer të administratës publike, të cilët dëshirojnë të marrin pjesë në programet e trajnimit dhe të kërkimit. Programi "Akademia e Diplomacisë Budapest 2015" ofrohet edhe për studentë ose punonjës civilë të institucioneve publike në Shqipëri.

Misioni i Universitetit Kombëtar të Shërbimit Publik (NUPS) është që të zbatojë me efektivitet programe arsimore, akademike dhe gjithëpërfshirëse në fushën e shërbimit shtetëror dhe publik me fokus shtetin dhe shërbimin publik.

Programet e kërkimit orientohen sipas studimeve evropiane në fushat e mbrojtjes dhe të Sigurisë Kombëtare. Kohëzgjatja e programit parashikon vetëm një semestër (shkurt-qershor 2015). Nëse ofrohet bursë, mbështetja financiare mujore nga shteti hungarez do të zgjasë për një periudhë 5 mujore shkurt-qershor 2015.

Kushtet e aplikimit:

Të gjithë aplikantët e interesuar për këto bursa studimi, deri më **31.12.2014**, duhet të regjistrohen online dhe të plotësojnë formularin e aplikimit online në gjuhën angleze përmes faqes së internetit të Universitetit Kombëtar të Shërbimit Publik:

<http://en.uni-nke.hu/study/academy-of-diplomacy-budapest/apply-now>;

Krahas aplikimit online, kandidati duhet të plotësojë dokumentet, sipas listës në vijim:

1. Formularin e aplikimit;
2. CV-në profesionale (sugjerohet përdorimi i modelit Europass);
3. Letër motivimi;
4. Letër motivimi për mbështetje financiare nga Universiteti (NUPS) sipas skemës të bursave të shtetit (Good Governance Scholarship Scheme);
5. Deklaratë sipas së cilës aplikanti bie dakord me Universitetin për nënshkrimin e kontratës për akordim burse;
6. Letër motivimi për llojin e bursës për të cilin kandidati ka aplikuar (bursë e plotë ose e pjesshme);

7. Kopje të noterizuar dhe të legalizuar të diplomës ose të ndonjë dokumenti të ngjashëm që vërteton mbarimin e programit të studimit të nivelit bachelor/M.Sh;
8. Kopje të noterizuar dhe të legalizuar të certifikatës së vlerësimit me të paktën 180 pikë krediti (ECTS). Komiteti përkatës i caktuar për transferimin e krediteve pranë Universitetit Kombëtar të Shërbimit Publik, ose Instituti i Studimeve Ndërkombëtare ka të drejtë të vendosë ose jo për pranimin e krediteve;
9. Kopje të noterizuar dhe të legalizuar të një diplome ose certifikatë ndërkombëtare për zotërimin e gjuhës angleze, që nënkupton certifikatë për nivelin e avancuar B2 ose certifikatë sipas Kornizës së Përbashkët Evropiane të Referencës (CEFR). Gjithashtu parashikohet që kandidatët e interesuar t'i nënshtrohen një testimi gojor për shkallën e njohurive të gjuhës angleze.

Këto dokumente detyrimisht duhet të përkthehen në gjuhën angleze ose hungareze. Krahas aplikimit online, dokumentet e plota duhet të dërgohen **me postë** në dy kopje origjinale pranë zyrës së Zv/rektorit për Çështjet Ndërkombëtare të Universitetit Kombëtar të Shërbimit Publik deri në datën **31 dhjetor 2014** në adresën e mëposhtme.

Norbert Kis PhD

Vice-Rector for Continuing Education and International Affairs

National University of Public Service

H-1441 Budapest, PO Box 60,

Hungary"

Theksojmë se përzgjedhja e kandidatëve fitues do të bëhet në bazë të vlerësimit me pikë nga Komisioni i Pranimit të Institutit NUPS i Studimeve Ndërkombëtare që ofron programin e bursave për shtetasit e huaj. Njoftimi për pranimin ose jo të aplikimit bëhet brenda 5 ditëve pas marrjes së vendimit nga Komisioni i Pranimit. Drejtori i Institutit NUPS i Studimeve Ndërkombëtare bën publikimin e rezultateve dhe njoftimin me shkrim për të gjithë aplikantët.

Kushtet për përfitimin e bursës, përshkrimi i detajuar, formularët e aplikimit, si dhe informacione të tjera referojuni adresave të mëposhtme:

<http://en.uni-nke.hu/study/programmes-in-english/academy-for-diplomacy-and-public-service/call-for-applications>

DREJTORIA E INTEGRIMIT DHE PROJEKTEVE